# Plani i kursit të arsimit në suedishten për të huaj

## Qëllimi i arsimit

Arsimi në suedishten për të huaj është një arsim i kualifikuar gjuhësor që ka për qëllim që imigrantëve të rritur t'u jap dituri themelore në gjuhën suedeze. Një nxënës me një gjuhë tjetër amtare se sa suedishtja përmes këtij arsimi duhet të mësoj dhe të zhvilloj një gjuhë të dytë funksionale. Ky arsim do t'u jap vegla gjuhësore për komunikim dhe pjesëmarrje aktive në jetën e përditshme atë profesionale dhe shoqërore. Ky arsim ka poashtu për qëllim që t'u jap të rriturve të imigruar aftësi themelore shkrimi dhe leximi nëse ata nuk i zotërojnë këto aftësi. Nëse një nxënës nuk aftësi funksionale leximi ose ka ndonjë sistem tjetër të shkruarit përveq alfabetit latin atij nxënësi do t'i jepet mësim në të shkruar dhe lexuar në kuadër të kornizës së këtij arsimi.

Mësimi duhet t'u dedikohet njerëzve me përvoja të ndryshme, situata të ndryshme jetësore, dituri dhe objektiva të ndryshme të arsimit. Mësimi duhet të planifikohet dhe të organizohet bashkë me nxënësin dhe t'i përshtatet interesave, përvojave diturive të përgjithshme dhe objektivave afatgjate të nxënësit.

Mësimi duke u nisur nga nevojat e individit duhet mundësuar që të kombinohet me punë apo aktivitete tjera si p.sh. orientim në jetën profesionale, validim, praktikë apo ndonjë trajnim tjetër. Pra mësimi duhet të organizohet në mënyrë fleksible, kur është në pyetje koha, vendi, përmbajtja dhe format e punës që nxënësi të ketë mundësi të marrë pjesë në procesin mësimor.

## Objektivi dhe karakteri i arsimit

Objektivi i arsimit suedishtja për imigrant është që nxënësi të zhvilloj

- aftësinë e vet për të shkruar dhe lexuar suedisht,
- aftësinë e vet për të folur, biseduar, lexuar, dëgjuar dhe të kuptuarit e suedishtes në kontekste të ndryshme,
- shqiptim të mirë,
- aftësinë e vet për të përdorur vegla relevante ndihmëse,
- aftësinë e vet për t'a përshtatur gjuhën e vet varësisht bashkëbiseduesëve dhe situatave,
- të kuptuarit se si mësohet një gjuhë, dhe
- strategjitë e të mësuarit dhe të komunikuarit për zhvillimin e mëtejmë gjuhësor.

Arsimi në suedishten për imigrant karakterizohet nga ajo që nxënësi të zhvilloj një aftësi komunikative gjuhësore. Kjo do të thotë të dij të komunikoj si me gojë ashtu edhe me shkrim, varësisht nga nevojat e tij. Nxënësi duhet të marrë dituri dhe aftësi të llojeve të ndryshme për të mundur të bëjë zgjedhje relevante gjuhësore në raport me situatën aktuale komunikative. Aftësia gjuhësore komunikative përfshinë kompetenca të ndryshme të cilat bashkëveprojnë dhe e kompletojnë njëra tjetrën. Një aftësi gjuhësore komunikative e kushtëzon pra qasjen në një sistem gjuhësor dhe dituri se si të përdoret ky sistem. Dituria rreth sitemit gjuhësor përfshinë fjalë, fraza, shqiptimin dhe strukturat gramatikore ndërsa dituria e përdorimit të gjuhës bënë fjalë si mund të ndërtohet një tekst dhe si bëhet zgjedhja gjuhësore funksionale dhe si bëhet përshtatja e gjuhës varësisht bashëbiseduesit dhe qëllimit të bisedës. Një kompetencë e rëndësishme është si si të përdoren strategji efikase për të bërë të qartë mesazhin e vet.

Në kuadër të suedishtes për imigrant nxënësi duhet të zhvilloj vetëdijen e tij se si bëhet mësimi i një gjuhe dhe të kuptuarit se si ai/ajo mund të mësoj. Nxënësi duhet poashtu të zhvilloj kompetencën e vet interkulturore duke reflektuar mbi përvojat e veta kulturore dhe duke i krahasuar ato me jetën e përditshme, profesionale dhe shoqërore në Suedi.

Në kuadër të suedishtes për imigrant nxënësi duhet të zhvilloj kompetencën e vet për të përdorur vegla të ndryshme digjitale dhe mjete ndihmëse informimi, komunikimi dhe mësimi.

Koncepti i zgjeruar i tekstit ka peshë të madhe në kuadër të mësimit suedishtja për imigrant. Të përvetsoj dhe të përpunoj tekste nuk dotë thotë gjithmonë lexim por do të thotë edhe dëgjim dhe studim arti dhe filmi.

## Bazat e ndërtimi të arsimit

Procesi mësimor përbëhet nga tri rrugë të ndryshme studimi, 1, 2 dhe 3, që u dedikohet personave me biografi, parakushte dhe objektiva të ndryshme. Rruga 1 e studimit përbëhet nga kurset A dhe B, rruga 2 e studimit nga kurset B dhe C si dhe rruga 3 e studimit nga kurset C dhe D. Këto katër kurse e qartësojnë progresin në mësim. Rruga 1 e studimit u dedikohet personave që kanë shumë pak shkollim nga e kaluara ndërsa rruga 3 e studimit personave që janë mësuar të studiojnë. Edhe pse një nxënës mund të përfundoj arsimin e suedishtes për imigrant sipas kurseve përkatëse apo rrugëve të studimit qëllimi është që të gjithë nxënësve t'u jepet mundësia për të studiuar deri në kursin D.

Dy prej kurseve gjenden në më shumë se dy rrugë studimi. Varësisht nga rruga e studimit secila prej këtyre dy kurseve, kursi B dhe ai C, mund të jenë ose kurse për fillestar ose kurse vazhdimësie. Pavarësisht nëse kurset janë për fillestar apo kurse vazhdimësie kriteret e kurseve janë të njëjta por forma e kurseve dallon varësisht nga përvoja e nxënësit për të studijuar, arsimit të tij të mëhershëm dhe sa e din suedishten me rastin e fillimt të kursit si dhe rrugës së zgjedhur të studimit. Se në cilin nivel një nxënës do të filloj varet nga vlerësimi që u bëhen njohurive të nxënësit, parakushteve të tij dhe gjërave tjera që kanë rëndësi për përmbushjen e kritereve që kërkohen.

Kurset janë të lidhura më kornizën e përbashkët evropiane për gjuhë; të mësuarit, procesi mësimor dhe vlerësimi. Kursi A i kundërpërgjigjet nivelit A1-/A1, kursi B i kundërpërgjigjet nivelit A1/A2, ndërsa kursi C i kundërpërgjigjet nivelit A2/A2+ dhe kursi D i kundërpërgjigjet B1/B+.

## Të mësurit e shkrim-leximit

Arsimi sa i përketë shkrim-leximit u dedikohet personave pa shkollim të mëhershëm apo personave që kanë shkollim të pakët dhe nuk dinë lexim funksional. Në këtë kurs u ofrohet mundësia të përvetsojnë aftësitë themelore të shkrim- leximit që nënkupton thellimin dhe automatizimin e diturive. Të bëhesh i lexueshëm në kuptimin e vërtetë të fjalës mund të marrë kohë të gjatë.

Ky arsim u dedikohet edhe personave që janë të lexueshëm por që kanë një alfabet tjetër përveç atij latin. Në këto raste procesi mësimor duket më ndryshe.

Të mësuarit e shkrim-leximit nuk lidhet me kurset A-D, por përbën një pjesë më vete që mund të mësohet në mënyrë të pavarur ose të kombinohet me njërin nga kurset. Pra është një proces që mund të vazhdoj gjatë gjithë kohës që nxënësi merrë pjesë në suedishten për imigrant në mënyrë që të arrihet automatizimi i njohurive. Mësimi mund të zhvillohet në gjuhën amtare të nxënësit apo gjuhë tjetër dhe është mirë të bëhet paralelisht me mësimin në gjuhën suedeze.

## Vlerësimi

Pikënisja e vlerësimit duhet të jetë aftësia e nxënësit për të përdorur gjuhën suedeze në nëmyrë të kuptueshme për qëlime të ndryshme në jetën e përditshme, profesionale dhe shoqërore. Vlerësimi duhet të përfshij dituritë e nxënësit në përputhshmëri me kriteret e kurseve për nota A, B,C,D dhe E. Kriteret e diturisë janë të formuluara duke u bazuar në pesë aspekte: kuptimi i të dëgjuarit, kuptimi i të lexuarit, interaksion gojor, prodhim gojor dhe aftësi shkrimi. Kriteret nuk duhet vlerësuar veçmas nga njëri tjetri por duhet bërë një vlerësim i tërësisë së aftësisë gjuhësore të nxënësit duke u bazuar se çka mund të përballoj nxënësi në aspektin gjuhësor. Korrektësia gjuhësore duhet të lidhet me përmbajtjen dhe kompleksitetin gjuhësor.

Pas kurseve B,C dhe D është një provim i obligueshëm kombëtar. Për kurset A-D notimi bëhet pas përfundimit të kursit. Në kuadër të mësimit të pjesëve të shkrim- leximit nuk bëhet notimi i nxënësit.

## Kriteret e njohurive

*Të kuptuarit e dëgjimit*

### *Kursi A (A1-/A1)*

Nxënësi me ndihmë kupton qartë, të folurit e thjesht në situata të përditshme.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi kupton **fjalë të zakonshme dhe fraza** të thjeshta të ngjarjeve të ripërsëritura në përditshmëri dhe kupton informacion të përshtatur dhe të qartë që është në interes të nxënësit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton udhëzime të thjeshta gojore duke vepruar **kryesisht në mënyrë funksionale** sipas atyre udhëzimeve. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi kupton **fraza dhe fjali të thjeshta** të ngjarjeve të ripërsëritura në përditshmëri dhe kupton informacion të përshtatur dhe të qartë që është në interes të nxënësit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton udhëzime të thjeshta gojore duke vepruar **relativisht mirë** dhe në mënyrë **funksionale** sipas atyre udhëzimeve. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi kupton **fjali dhe fraza të një konteksti** të ngjarjeve të ripërsëritura në përditshmëri dhe kupton informacion të përshtatur dhe të qartë që është në interes të nxënësit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton udhëzime të thjeshta gojore duke vepruar në mënyrë të **mirë funksionale** sipas atyre udhëzimeve. |

### *Kursi B (A1/A2)*

Nxënësi mund të kuptoj qartë, të folurit e thjesht në jetën e përditshme.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të thjesht të **përmbajtjes kryesore.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe të qarta dhe udhëzime në jetën e përditshme duke vepruar **kryesisht në mënyrë funksionale** sipas atyre udhëzimeve. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të thjesht të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe të qarta dhe udhëzime në jetën e përditshme duke vepruar **relativisht mirë** dhe në mënyrë **funksionale** sipas atyre udhëzimeve. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të thjesht të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme dhe nuanca të rralla.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe të qarta dhe udhëzime në jetën e përditshme duke vepruar në mënyrë të **mirë funksionale** sipas atyre udhëzimeve. |

*Kursi C (A2/A2+)*

Nxënësi mund të kuptoj qartë, të folurit e thjesht në situata të rëndomta të jetës së përditshme, profesionale dhe shoqërore.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, përshkrime, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të thjesht të **përmbajtjes kryesore.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe të qarta dhe udhëzime në jetën e përditshme duke vepruar **kryesisht në mënyrë funksionale** sipas atyre udhëzimeve. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, përshkrime, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të thjeshtë të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe të qarta dhe udhëzime në jetën e përditshme në jetën e përditshme duke vepruar **relativisht mirë** dhe në mënyrë **funksionale** sipas atyre udhëzimeve. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, përshkrime, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të thjesht të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme dhe nuanca të caktuara.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe të qarta dhe udhëzime në jetën e përditshme duke vepruar në mënyrë të **mirë funksionale** sipas atyre udhëzimeve. |

*Kursi D (B1/B1+)*

Nxënësi mund të kuptoj të folurit e qartë në situata në formale dhe jo-formale të jetës së përditshme, profesionale dhe shoqërore.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi shpreh se kupton tregime, përshkrime, biseda, diskutime, informacione dhe emisione lajmesh rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të **përmbajtjes kryesore.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton udhëzime gojore të qarta dhe me hollësira duke vepruar **kryesisht në mënyrë funksionale** sipas atyre udhëzimeve. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi shpreh se kupton tregime, përshkrime, biseda, diskutime, informacione dhe emisione lajmesh rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton udhëzime gojore të qarta dhe me hollësira duke vepruar **relativisht mirë** dhe në mënyrë **funksionale** sipas atyre udhëzimeve. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi shpreh se kupton tregime, përshkrime, biseda, diskutime, informacione dhe emisione lajmesh rreth temave të njohura duke e bërë një përmbledhje të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme dhe nuanca të caktuara.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton udhëzime gojore të qarta dhe me hollësira duke vepruar në mënyrë të **mirë funksionale** sipas atyre udhëzimeve. |

## Kriteret e njohurive

*Të kuptuarit e leximit*

### *Kursi A (A1-/A1)*

Nxënësi mund të nxjerr dhe kuptoj informacion të thjesht dhe konkret në situata të përditshmërisë.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi mund të nxjerr dhe kuptoj informacion në formë të **fjalëve të zakonshme dhe simboleve.** | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi mund të nxjerr dhe kuptoj informacion në formë të **fjalëve të zakonshme dhe simboleve si dhe frazave shumë të thjeshta** | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi mund të nxjerr dhe kuptoj informacion në formë të **fjalëve të zakonshme dhe simboleve si dhe frazave dhe fjalive shumë të thjeshta.** |

### *Kursi B (A1/A2)*

Nxënësi di të lexoj, kuptoj dhe të përdorë tekste të thjeshta në situata të përditshmërisë

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi lexon tekste të përshtatura dhe përshkruese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të thjeshta të **përmbajtjes kryesore.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe personale, informacion të shkurtë dhe konkret, udhëzime të qarta dhe të thjeshta duke vepruar **kryesisht në mënyrë funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji leximi **kryesisht në mënyrë funksionale.** | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi lexon tekste të përshtatura dhe përshkruese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të thjeshta të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe personale, informacion të shkurtë dhe konkret, udhëzime të qarta dhe të thjeshta duke vepruar **relativisht mirë** dhe në mënyrë **funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji leximi në mënyrë **adekuate me qëllimin.** | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi lexon tekste të përshtatura dhe përshkruese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të thjeshta të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme dhe nuanca të rralla.**<br><br>Nxënësi shpreh se kupton mesazhe personale, informacion të shkurtë dhe konkret, udhëzime të qarta dhe të thjeshta duke vepruar në mënyrë të **mirë funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji leximi në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin.** |

*Kursi C (A2/A2+)*

Nxënësi di të lexoj, kuptoj dhe të përdorë tekste të rëndomta të jetës së përditshme, shoqërore dhe profesionale.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi lexon tekste rrëfyese dhe përshkruese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të thjeshta të **përmbajtjes kryesore.**<br><br>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste faktike, tabela dhe diagrame dhe mund të bëjë shpjegime të **thjeshta** rreth informacionit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta dhe të shkurta duke vepruar **kryesisht në mënyrë funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji leximi **kryesisht në mënyrë funksionale.** | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi lexon tekste rrëfyese dhe përshkruese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të thjeshta të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme.**<br><br>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste faktike, tabela dhe diagrame dhe mund të bëjë shpjegime të **thelluara** rreth informacionit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta dhe të shkurta duke vepruar **relativisht mirë** dhe në mënyrë **funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji të ndryshme leximi në mënyrë **adekuate me qëllimin** që ka leximi. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi lexon tekste rrëfyese dhe përshkruese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të thjeshta të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme dhe nuanca të rralla.**<br><br>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste faktike, tabela dhe diagrame dhe mund të bëjë shpjegime të **thelluara mirë** rreth informacionit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta dhe të shkurta duke vepruar në mënyrë të **mirë funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji të ndryshme leximi në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** që ka leximi. |

*Kursi D (B1/B1+)*

Nxënësi di të lexoj, kuptoj dhe të përdorë tekste të një kompleksiteti të caktuar në jetën e përditshme, profesioanle dhe shoqërore

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi lexon tekste rrëfyese, përshkruese dhe argumentuese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të **përmbajtjes kryesore.**<br><br>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste faktike, tabela dhe mund të bëjë shpjegime të **thjeshta** rreth informacionit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta duke vepruar **kryesisht në mënyrë funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji të ndryshme leximi **kryesisht në mënyrë funksionale** bazuar në qëllimin e leximit. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi lexon tekste rrëfyese, përshkruese dhe argumentuese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme.**<br><br>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste faktike, tabela dhe mund të bëjë shpjegime të **thelluara** rreth informacionit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta duke vepruar **relativisht mirë** dhe në mënyrë **funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji të ndryshme leximi në mënyrë **adekuate me qëllimin** që ka leximi. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi lexon tekste rrëfyese, përshkruese dhe argumentuese rreth temave të njohura dhe këtë e shpreh duke bërë përmbledhje të **përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësira të rëndësishme dhe nuanca të caktuara.**<br><br>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste faktike, tabela dhe mund të bëjë shpjegime të **thelluara mirë** rreth informacionit.<br><br>Nxënësi shpreh se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta duke vepruar në mënyrë të **mirë funksionale** sipas atyre udhëzimeve.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë strategji të ndryshme leximi në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** që ka leximi. |

## Kriteret e njohurive

*Interaksion gojor*

### *Kursi A (A1-/A1)*

Nxënësi mund të lidh kontakte sociale dhe me ndihmë komunikon rreth situatave konkrete të përditshmërisë.

| Notat E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi merr pjesë në biseda shumë të thjeshta e të përditshme duke përdorur **fjalë dhe fraza të thjeshta përshëndetëse, lamtumirëse dhe mirësjellëse** dhe bën pyetje dhe përgjigjet thjesht varësisht nga nevoja konkrete.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** gjeste, pyetje dhe strategji tjera për të kuptuar dhe për t'a kuptuar. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi merr pjesë në biseda shumë të thjeshta e të përditshme duke përdorur **fjalë dhe fraza të zakonshme** dhe bën pyetje dhe përgjigjet thjesht varësisht nga nevoja konkrete.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** gjeste, pyetje dhe strategji tjera për të kuptuar dhe për t'a kuptuar. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi merr pjesë në biseda shumë të thjeshta e të përditshme duke përdorur **fjalë, fraza dhe fjali** dhe bën pyetje dhe përgjigjet thjesht varësisht nga nevoja konkrete.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** gjeste, pyetje dhe strategji tjera për të kuptuar dhe për t'a kuptuar. |

### *Kursi B (A1/A2)*

Nxënësi me ndihmë mund të komunikoj në sitauta të zakonshme në jetën e përditshme.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi merr pjesë në biseda të thjeshta rreth temave të njohura duke paraqitur dhe reaguar ndaj pohimeve, mendimeve dhe dëshirave si dhe bën pyetje dhe përgjigjet në atë mënyrë që **pjesërisht** të mbahet rrjedha e bisedës.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** strategji për të kuptuar dhe për t'a kuptuar. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi merr pjesë në biseda të thjeshta rreth temave të njohura duke paraqitur dhe reaguar ndaj pohimeve, mendimeve dhe dëshirave si dhe bën pyetje dhe përgjigjet në atë mënyrë që të mbahet rrjedha e bisedës **relativisht mirë.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** strategji për të kuptuar dhe për t'a kuptuar. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi merr pjesë në biseda të thjeshta rreth temave të njohura duke paraqitur dhe reaguar ndaj pohimeve, mendimeve dhe dëshirave si dhe bën pyetje dhe përgjigjet në atë mënyrë që të mbahet rrjedha e bisedës **mirë.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** strategji për të kuptuar dhe për t'a kuptuar. |

*Kursi C (A2/A2+)*

Nxënësi mundet që nëse përshtatet qëllimi dhe partneri i bisedës të komunikoj me një gjuhë të thjeshtë në situata të zakonshme në jetën e përditshme, profesionale dhe shoqërore.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta rreth temava të njohura duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, pikëpamjeve dhe informatave në atë mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon **pjesërisht përpara.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** strategji e cila e lehtëson interaksionin. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta rreth temava të njohura duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, pikëpamjeve dhe informatave në atë mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon përpara.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** strategji e cila e lehtëson interaksionin. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta rreth temava të njohura duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, pikëpamjeve dhe informatave në atë mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon përpara dhe i thellon apo i zgjeron ato.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** strategji e cila e lehtëson interaksionin. |

*Kursi D (B1/B1+)*

Nxënësi mundet që nëse përshtatet qëllimi dhe partneri i bisedës të komunikoj në situata formale dhe joformale në jetën e përditshme, profesionale dhe shoqërore.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Betyget A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta rreth temava të njohura duke i shfaqur dhe kundërvë pikëpamjeve me argumente të **thjeshta** si dhe duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, dhe informatave në atë mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon **pjesërisht përpara.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** strategji të cilat zgjedhin problemet në interaksion. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta rreth temava të njohura duke i shfaqur dhe kundërvë pikëpamjeve me argumente të **thelluara** si dhe duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, dhe informatave në atë mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon **përpara.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** strategji të cilat zgjedhin problemet në interaksion. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta rreth temava të njohura duke i shfaqur dhe kundërvë pikëpamjeve me argumente të **thelluara mirë** si dhe duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, dhe informatave në atë mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon **përpara dhe i thellon apo i zgjeron ato.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** strategji të cilat zgjedhin problemet në interaksion. |

## Kriteret e njohurive

*Prodhim gojor*

### *Kursi A (A1-/A1)*

Nxënësi mund që me ndihmë të komunikoj me një gjuhë të thjesht në disa situata që kanë të bëjnë për vetveten.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi tregon me **fjalë të zakonshme dhe fraza të thjeshta** për rrethanat personale dhe përvojat.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** gjeste dhe strategji tjera për t'a kuptuar të tjerët. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi tregon me **fjalë dhe fraza të thjeshta** për rrethanat personale dhe përvojat.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** gjeste dhe strategji tjera për t'a kuptuar të tjerët. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi tregon me **fjalë dhe fraza koherente** për rrethanat personale dhe përvojat.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** gjeste dhe strategji tjera për t'a kuptuar të tjerët. |

### *Kursi B (A1/A2)*

Nxënësi mund që me ndihmë të komunikoj me një gjuhë të thjesht dhe me gjeste në situata të jetës së përditëshme.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi tregon në formë të **thjesht** rreth përvojave personale dhe personave që i njeh mirë, vendeve dhe ngjarjeve.<br><br>Nxënësi shprehet **kuptueshëm** dhe **pjesërisht kohorente.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** gjeste dhe strategji tjera për t'a kuptuar të tjerët. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi tregon në formë të **thelluar** rreth përvojave personale dhe personave që i njeh mirë, vendeve dhe ngjarjeve.<br><br>Nxënësi shprehet **relativisht qartë** dhe **relativisht mirë** në aspektin **kohorent.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** gjeste dhe strategji tjera për t'a kuptuar të tjerët. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi tregon në formë të **më të thelluar** rreth përvojave personale dhe personave që i njeh mirë, vendeve dhe ngjarjeve.<br><br>Nxënësi shprehet **qartë** dhe **mirë** në aspektin **kohorent.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** gjeste dhe strategji tjera për t'a kuptuar të tjerët. |

*Kursi C (A2/A2+)*

Nxënësi mundet duke i'u përshtatur qëllimi dhe bashkëbiseduesi të komunikoj me një gjuhë të thjesht në situata të zakonshme në jetën e përditshme, profesionale dhe shoqërore.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të **thjesht** rreth përvojave personale dhe temave të njohura si dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.<br><br>Nxënësi shprehet **kuptueshëm** dhe **pjesërisht kohorente** dhe tregon të një variacion të **caktuar** gjuhësor.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** strategji të ndryshme për të përmirësuar komunikimin. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të **thelluar** rreth përvojave personale dhe temave të njohura si dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.<br><br>Nxënësi shprehet **relativisht qartë** dhe **relativisht mirë** në aspektin **kohorent** dhe tregon të një variacion **krahasimisht të mirë** gjuhësor**.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** strategji të ndryshme për të përmirësuar komunikimin. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të **më të thelluar** rreth përvojave personale dhe temave të njohura si dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.<br><br>Nxënësi shprehet **qartë** dhe **mirë** në aspektin **kohorent** dhe tregon të një variacion **të mirë** gjuhësor**.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** gjeste dhe strategji të ndryshme për të përmirësuar komunikimin. |

*Kursi D (B1/B1+)*

Nxënësi mundet duke i'u përshtatur qëllimi dhe bashkëbiseduesi të komunikoj në situata formale dhe joformale në jetën e përditshme, profesionale dhe shoqërore.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të **thjesht** ngjarje aktuale, përvoja, përshtypje dhe mendime dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.<br><br>Nxënësi shprehet **deri diku rrjedhshëm** dhe **pjesërisht kohorente** dhe tregon të një variacion të **caktuar** gjuhësor.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** strategji të ndryshme për të përmirësuar komunikimin. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të **thelluar** ngjarje aktuale, përvoja, përshtypje dhe mendime dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.<br><br>Nxënësi shprehet **relativisht me rrjedhshmëri të mirë** dhe **relativisht mirë** në aspektin **kohorent** dhe tregon një variacion **krahasimisht të mirë** gjuhësor**.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** strategji të ndryshme për të përmirësuar komunikimin. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të **thelluar mirë** ngjarje aktuale, përvoja, përshtypje dhe mendime dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.<br><br>Nxënësi shprehet **me rrjedhshmëri të mirë** dhe **mirë** në aspektin **kohorent** dhe tregon një variacion **mirë** gjuhësor**.**<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** strategji të ndryshme për të përmirësuar komunikimin. |

## Kriteret e njohurive

*Aftësi shkrimi*

### *Kursi A (A1-/A1)*

Nxënësi mund të përballoj disa situata të përditshmërisë ku paraqitet të shkruarit.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi shkruan nënshkrimin e vet dhe jep **kontribut për të plotësuar** të dhëna personale që përshtaten në formularë të thjesht të zakonshëm.<br><br>Nxënësi shkruan **kryesisht në mënyrë funksionale** nga një informacion rëndësishëm sipas nevojave personale. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi shkruan nënshkrimin e vet dhe **plotëson** të dhëna personale të cilat **pas një përpunimi** përshtaten në formularë të thjesht të zakonshëm.<br><br>Nxënësi shkruan në mënyrë **relativisht mirë funksionale** nga një informacion rëndësishëm sipas nevojave personale. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi shkruan nënshkrimin e vet dhe **plotëson** të dhëna personale të cilat përshtaten në formularë të thjesht të zakonshëm.<br><br>Nxënësi shkruan mënyrë të mirë **funksionale** nga një informacion rëndësishëm sipas nevojave personale. |

### *Kursi B (A1/A2)*

Nxënësi mund të shkruaj me dorë dhe në kompjuter tekste të thjeshta për të komunikuar në situata rë rëndomta në situata të përditëshme.

| Nota E | Nota D | Nota C | Nota B | Nota A |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi shkruan mesazhe të tjeshta, shkurta **kuptueshëm,** përshëndetje, tekste rreth vetes dhe ngjarjeve të përjetuara.<br><br>Nxënësi krijon **kryesisht në mënyrë funksionale** në kohorencë.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** disa strategji në të shkruar. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi shkruan mesazhe të tjeshta, shkurta dhe **relativisht të qarta,** përshëndetje, tekste rreth vetes dhe ngjarjeve të përjetuara.<br><br>Nxënësi krijon në mënyrë **relativisht mirë funksionale** në kohorencë.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** disa strategji në të shkruar. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi shkruan mesazhe të tjeshta, shkurta dhe të qarta, përshëndetje, tekste rreth vetes dhe ngjarjeve të përjetuara.<br><br>Nxënësi krijon në mënyrë të mirë funksionale në kohorencë.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** disa strategji në të shkruar. |

*Kursi C (A2/A2+)*

Nxënësi mund të shkruaj tekste të thjeshta duke i'u përshtatur qëllimi dhe destinacioni për të komunikuar në situata të jetës së përditshme, profesionale dhe shoqërore.

| **Nota E** | **Nota D** | **Nota C** | **Nota B** | **Nota A** |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi shkruan tekste në mënyrë kohorente dhe të **kuptueshme** rreth përvojave, përshtypjeve, mendimeve si dhe tekste me fakte dhe përmbajtje formale rreth temave të njohura.<br><br>Nxënësi krijon **kryesisht në mënyrë funksionale** struktur në tekste dhe tregon në **variacion të caktuar** të leksikut dhe ndërtimit të fjalive.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** strategji të ndryshme në të shkruar. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi shkruan tekste në mënyrë kohorente dhe të **relativisht të qarta** rreth përvojave, përshtypjeve, mendimeve si dhe tekste me fakte dhe përmbajtje formale rreth temave të njohura.<br><br>Nxënësi krijon një struktur **relativisht mirë funksionale** në tekstet e veta dhe tregon një **variacion krahasimisht të mirë** të leksikut dhe ndërtimit të fjalive.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** strategji të ndryshme në të shkruar. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi shkruan tekste në mënyrë kohorente dhe të **relativisht të qarta** rreth përvojave, përshtypjeve, mendimeve si dhe tekste me fakte dhe përmbajtje formale rreth temave të njohura.<br><br>Nxënësi krijon një struktur të **mirë funksionale** në tekstet e veta dhe tregon një **variacion të mirë** të leksikut dhe ndërtimit të fjalive.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** strategji të ndryshme në të shkruar. |

*Kursi D (B1/B1+)*

Nxënësi Nxënësi mund të shkruaj tekste të thjeshta duke i'u përshtatur qëllimi dhe destinacioni për të komunikuar si në situata formale ashtu edhe joformale të jetës së përditshme, profesionale dhe shoqërore.

| **Betyget E** | **Betyget D** | **Betyget C** | **Betyget B** | **Betyget A** |
|---|---|---|---|---|
| Nxënësi shkruan me një **rrjedhshmëri** të caktuar tekste rreth temave të njohura në mënyrë përshkruese, raportuese dhe argumentuese.<br><br>Nxënësi krijon **kryesisht në mënyrë funksionale** struktur në tekste dhe tregon në **variacion të caktuar** të leksikut dhe ndërtimit të fjalive.<br><br>Nxënësi përdorë me një **siguri të caktuar** struktura të thjeshta dhe të avancuara gramatikore në tekstet e veta.<br><br>Nxënësi mban dhe përmbledh **kryesisht në mënyrë funksionale** shënime për të shkruarit e vet.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë **kryesisht në mënyrë funksionale** strategji të ndryshme në të shkruar. | Nota D do të thotë se kriteri i njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së është përmbushur. | Nxënësi shkruan me një **rrjedhshmëri relativisht të mirë** tekste rreth temave të njohura në mënyrë përshkruese, raportuese dhe argumentuese.<br><br>Nxënësi krijon një struktur **relativisht mirë funksionale** në tekstet e veta dhe tregon një **variacion krahasimisht të mirë** të leksikut dhe ndërtimit të fjalive.<br><br>Nxënësi përdorë me një **siguri relativisht të mirë** struktura të thjeshta dhe të avancuara gramatikore në tekstet e veta.<br><br>Nxënësi mban dhe përmbledh **relativisht mirë funksionale** shënime për të shkruarit e vet.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **adekuate me qëllimin** strategji të ndryshme në të shkruar. | Nota B do të thotë se kriteri i njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së është i përmbushur. | Nxënësi shkruan me një **rrjedhshmëri** të mirë tekste rreth temave të njohura në mënyrë përshkruese, raportuese dhe argumentuese.<br><br>Nxënësi krijon një struktur të **mirë funksionale** në tekstet e veta dhe tregon një **variacion të mirë** të leksikut dhe ndërtimit të fjalive.<br><br>Nxënësi përdorë me një **siguri të mirë** struktura të thjeshta dhe të avancuara gramatikore në tekstet e veta.<br><br>Nxënësi mban dhe përmbledh në mënyrë të **mirë funksionale** shënime për të shkruarit e vet.<br><br>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë **efektive dhe adekuate me qëllimin** strategji të ndryshme në të shkruar. |